

2024

Raport Vjetor 2024
**SEKTORI I BURIMEVE
NJERËZORE**



PRISHTINA

Data: 18.12.2024

Raporti Vjetor 2024 Sektori i Burimeve

Njerëzore Nr. i Protokollit: 14-052/01-0166905/24

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i përgatitur paraqet fluksin e punës kryesisht për procesin e rekrutimit nga ana e Sektorit të Burimeve Njerëzore për vitin 2024, duke pasqyruar të dhënat sasiore se si kemi proceduar me fazat e rekrutimit varësisht nga lloji i procedurës së rekrutimit. Gjithashtu përmenden në mënyrë të përgjithshme edhe llojet e shërbimeve dhe natyra e punës të cilën e kryejmë duke përmendur edhe natyrën e akteve, organizimit të ngritjes së kapaciteteve për shërbyesit civil si dhe punët/angazhimet tjera që janë listuar në vazhdim gjatë këtij raporti. Me qenë se është e pamundur prezantimi i indikatorëve për numrin e palëve të cilat janë shërbyer, jemi fokusuar në indikatorët për procedurat e rekrutimit të cilat për çdo kategori janë të pasqyruara në vazhdim.

Nga procedurat e rekrutimit për shërbimin civil janë 80 procedura të rekrutimit nga të cilat 40 janë përfunduar plotësisht ndërsa edhe 40 tjera janë në fazë përfundimtare, për të cilat në vazhdim janë të paraqitura detajet respektive në kuadër të raportit. E rëndësishme është që krahas këtyre procedurave të përmendim plotësimin e nevojave të shumë drejtorive për rekrutim, duke u përgjigjur në kërkesat e tyre si dhe plotësimin të pozitive të caktuara. Duke qenë se për kohë të gjatë numri i rekrutimit të stafit ka qenë në numër minimal për këtë vit kemi trajtuar pensionet, rastet e vdekjes si dhe plotësokemi arritur që të zbusim mungesën e stafit në shumë dikastere, për të përbushur kërkesat e qytetarëve që parashtrajnë në kryeqytet.

Sa i përket shërbimit publik për institucionet aftësuese edukativo-arsimore janë rekrutuar gjithësej 258 persona mësimdhënës, sekretar, asistent për fëmijë me nevoja të vecanta etj, 3 persona në nivel të ulët drejtues për institucione kulturore, si dhe 91 persona për institucionet shëndetësore. Poashtu sa i përket Stafit Administrativ Teknik jaë shpallur 5 procedura të rekrutimit, njëra nga ato është anuluar për shkak të ndryshimeve legjislativë në Ligjin e Pyjeve, ku Kryeqyteti nuk ka pasur mundësi të vazhdoj tutje me njërin nga këto procedura e cila ishte inicuar në fillim.

E rëndësishme të thuhet është se procedurat e rekrutimit për cilëndo nga kategoritë e përmendura në kuadër të ligjit paraqesin vetëm një pjesë të nevojshme të funksioneve dhe angazhimeve të përditshme të cilat ne i ushtrojmë gjatë ditës. Konsiderojmë se pjesa e operacioneve të përditshme është shumë më voluminoze se pjesa e procedurave të rekrutimit duke qenë se nuk mund t'a parashikojmë qoftë numrin e kërkesave apo parashtrësive tjera të cilat vijnë nga palët. Poashtu ndryshimet ligjore të vazhdueshme kanë imponuar vazhdimisht lëvizje si dhe ndryshime në akt emërimi, kontrata dhe forma tjera të vendimeve apo akteve juridike të cilat lëshohen nga ana e sektorit.

Kemi qenë vazhdimisht të angazhuar edhe në asistimin e Drejtorive dhe Njësive tjera të cilat kanë kërkuar vazhdimisht asistencë si dhe mbështetje për të administruar edhe tema dhe çështje të caktuara së bashku me njësitë tjera.

Hyrje

Sektori i Burimeve Njerëzore të Kryeqytetit për Vitet 2024, në kuadër të ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara me dispozita ligjore ka shpallur dhe administruar konkurset për pranim të nëpunësve civil, shërbyesve publik, stafit administrativ teknik, si dhe stafit me mardhënie kontraktuale. Krahas menaxhimit të konkurse për pranim, trajtimit të kërkesave, ankesave dhe parashtresave tjera të paraqitura nga ana e zyrtarëve publik në kuadër të Kryeqytetit. Në vazhdim do pasqyrohet në kuadër të raportit numri i procedurave të rekrutimit si dhe llojet e shërbimeve të cilat i ofron Sektori i Burimeve Njerëzore i Kryeqytetit.


Për të garantuar respektimin e kornizës ligjore për Zyrtarët Publik, si sektor kemi themeluar komisionet për: Komisioni Disiplinor për Shërbyes Civil, Komisioni Disiplinor për Shërbyes Publik dhe Staf Administrativ/ Teknik, Komisionin e Ankesave për Shërbyes Publik dhe Staf Administrativ/ Teknik, si dhe komisionet Ad-hoc të ankesave për procedurat e rekrutimit të Shërbyesve Publik. Sektori i Burimeve Njerëzore, përgatit dhe organizon ngritjen e kapaciteteve të Zyrtarëve Publik, duke marrë për bazë nevojat dhe kërkesat tjera profesionale nga Drejtoritë dhe Sektorët e Kryeqytetit, për të arritur performancë më të mirë dhe realizuar detyrat e përditshme përmes së cilave obligohet administrata dhe shërbyesit publik të ofrojnë shërbime të caktuara.

Sektori i Burimeve Njerëzore në përmbushje të mandatit dhe obligimeve ligjore që dalin nga Ligji për Zyrtarët Publik dhe Ligjet tjera, gjithashtu ka kryer vlersimin e performancës, mbledhjen dhe vendosjen e vlerësimeve individuale në dosjen e çdo nëpunësi, formalizuar mardhënien e punës përmes aktemërimeve dhe procedura tjera të ngjajshme që janë në funksion të mbështetjes dhe organizimit të punës së nëpunësve të Komunës së Prishtinës.

Pranimi në Shërbim Civil

Në 80 konkurse për pranim në shërbimin civil të shpallura nga Kryeqyteti, janë përmbyllur 40 procedura rekrutimit për të cilat ka përfunduar procedura e përzgjedhjes si dhe procedura e ankesës. Procedura si në konkurset paraprake ka qenë verifikimi paraprak i çdo kandidati, të cilët pastaj kanë vazhduar tutje me procedurat tjera të definuara (në testim me shkrim si dhe në intervistë me gojë).

Procedura të Rekrutimit



■ Në Proces ■ Të përfunduara

Grafikoni 1

Shprehur në përqindje 50% e konkurseve janë përmbyllur me sukses, ndërsa 50% konkurseve janë në proces të përfundimit (ku për numrin më të madh të tyre janë përfunduar edhe procedurat e testimit dhe intervistës mirëpo e presim afatin e ankesave për të përmbyllur procedurën). Për të dhëna më të detajuara të konkurseve për avancim, shih të bashkangjitur Tabelën 1, në vazhdim:

Kodi Code Kod	Kategoria funktionale Functional category Funkcionalna kategorija	Titulli i pozitës së punës Job position title Naziv radnog mesta	Titulli i pozitës Position title Naziv pozicije	Statusi Status Status
RPC0009044	Niveli profesional	Zyrtar për Mbështetje Administrativo Teknike të Kuvendit Komunal	Profesional 3	Në proces
RPC0009013	Niveli i ulët drejtues	Udhëheqës i Sektorit për Menaxhimin e Kontratave të Ndërtimeve të Ulët	Drejtues i Ulët	Në proces
RPC0008981	Niveli i ulët drejtues	Udhëheqës i Sektorit për Investimeve Kapitale	Drejtues i Ulët	Në proces
RPC0008959	Niveli i ulët drejtues	Udhëheqës i Sektorit për pronësi, shpronësim dhe këmbime	Drejtues i Ulët	Në proces
RPC0008954	Niveli i ulët drejtues	Udhëheqës i Sektorit për Pronë	Drejtues i Ulët	Në proces
RPC0008919	Niveli profesional	Referent	Profesional 3	Në proces
RPC0008918	Niveli profesional	Zyrtar për Gjendje Civile 1	Profesional 3	Në proces
RPC0008917	Niveli profesional	Zyrtar Ligjor	Profesional 2	Në proces
RPC0008892	Niveli profesional	Zyrtar i Lartë për politika te Turizmit	Profesional 1	Në proces
RPC0008840	Niveli profesional	Zyrtar për Buxhet dhe Financa 2	Profesional 2	Në proces
RPC0008839	Niveli profesional	Zyrtar për Shërbim me Qytetarë	Profesional 3	Në proces
RPC0008833	Niveli profesional	Zyrtar Administrativ	Profesional 2	Në proces
RPC0008832	Niveli profesional	Zyrtar për Shërbime Sociale 2	Profesional 2	Në proces
RPC0008797	Niveli i ulët drejtues	Udhëheqës i Sektorit për Gjendje Civile	Drejtues i Ulët	Në proces
RPC0008725	Niveli profesional	Zyrtar për Shërbime Sociale 2	Profesional 2	Në proces
RPC0008698	Niveli i ulët drejtues	Menaxher i Burimeve Njerëzore	Drejtues i Ulët	Në proces
RPC0008640	Niveli i ulët drejtues	Udhëheqës i Sektorit për Integrim Evropian	Drejtues i Ulët	Në proces
RPC0008619	Niveli profesional	Auditor i Brendshëm	Profesional 1	Në proces
RPC0008433	Niveli profesional	Zyrtar Ligjor	Profesional 2	Në proces
RPC0008359	Niveli profesional	Zyrtar i Lartë i Prokurimit	Profesional 1	Në proces
RPC0008175	Niveli profesional	Inspektor i Shërbimeve Publike	Profesional 1	Në proces
RPC0009044	Niveli profesional	Zyrtar për Mbështetje Administrativo Teknike të Kuvendit Komunal	Profesional 3	Në proces

RPC0009013	Niveli i ulët drejtues	Udhëheqës i Sektorit për Menaxhimin e Kontratave të Ndërtimeve të Ulët	Drejtues i Ulët	Në proces
RPC0008981	Niveli i ulët drejtues	Udhëheqës i Sektorit për Investimeve Kapitale	Drejtues i Ulët	Në proces
RPC0008959	Niveli i ulët drejtues	Udhëheqës i Sektorit për pronësi, shpronësim dhe këmbime	Drejtues i Ulët	Në proces
RPC0008954	Niveli i ulët drejtues	Udhëheqës i Sektorit për Pronë	Drejtues i Ulët	Në proces
RPC0008919	Niveli profesional	Referent	Profesional 3	Në proces
RPC0008918	Niveli profesional	Zyrtar për Gjendje Civile 1	Profesional 3	Në proces
RPC0008917	Niveli profesional	Zyrtar Ligjor	Profesional 2	Në proces
RPC0008892	Niveli profesional	Zyrtar i Lartë për politika te Turizmit	Profesional 1	Në proces
RPC0008840	Niveli profesional	Zyrtar për Buxhet dhe Financa 2	Profesional 2	Në proces
RPC0008839	Niveli profesional	Zyrtar për Shërbim me Qytetarë	Profesional 3	Në proces
RPC0008833	Niveli profesional	Zyrtar Administrativ	Profesional 2	Në proces
RPC0008832	Niveli profesional	Zyrtar për Shërbime Sociale 2	Profesional 2	Në proces
RPC0008797	Niveli i ulët drejtues	Udhëheqës i Sektorit për Gjendje Civile	Drejtues i Ulët	Në proces
RPC0008725	Niveli profesional	Zyrtar për Shërbime Sociale 2	Profesional 2	Në proces
RPC0008698	Niveli i ulët drejtues	Menaxher i Burimeve Njerëzore	Drejtues i Ulët	Në proces
RPC0008640	Niveli i ulët drejtues	Udhëheqës i Sektorit për Integrim Evropian	Drejtues i Ulët	E suksesshme
RPC0008619	Niveli profesional	Auditor i Brendshëm	Profesional 1	Në proces
RPC0008433	Niveli profesional	Zyrtar Ligjor	Profesional 2	Në proces
RPC0008359	Niveli profesional	Zyrtar i Lartë i Prokurimit	Profesional 1	Në proces
RPC0008175	Niveli profesional	Inspektor i Shërbimeve Publike	Profesional 1	E suksesshme
RPC0007875	Niveli i ulët drejtues	Udhëheqës i Sektorit për Shërbime të Përbashkëta	Drejtues i Ulët	E suksesshme
RPC0007804	Niveli profesional	Zyrtar i Lartë i Personelit	Profesional 1	E suksesshme
RPC0007793	Niveli profesional	Zyrtar për Lektorim	Profesional 2	E suksesshme
RPC0007792	Niveli profesional	Zyrtar për Gjendje Civile 1	Profesional 3	E suksesshme
RPC0007625	Niveli i ulët drejtues	Udhëheqës i Sektorit për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete	Drejtues i Ulët	E suksesshme
RPC0007514	Niveli profesional	Zyrtar për Shëndetësi	Profesional 2	E suksesshme
RPC0007513	Niveli profesional	Zyrtar për Shëndetësi	Profesional 2	E suksesshme
RPC0007512	Niveli profesional	Zyrtar për Shëndetësi	Profesional 2	E suksesshme


RPC0007423	Niveli profesional	Zyrtar për kulturë	Profesional 2	E suksesshme
RPC0007372	Niveli profesional	Zyrtar i Lartë për Promovim të Kulturës	Profesional 1	E suksesshme
RPC0007338	Niveli profesional	Asistent Administrativ	Profesional 3	E suksesshme
RPC0007337	Niveli profesional	Zyrtar për Promovimin e Turizmit	Profesional 2	E suksesshme
RPC0007336	Niveli profesional	Zyrtar për kulturë	Profesional 2	E suksesshme
RPC0007265	Niveli profesional	Zyrtar për Arkiv 2	Profesional 2	E suksesshme
RPC0007263	Niveli profesional	Zyrtar për Zotimin e Mjeteve Buxhetore	Profesional 2	E suksesshme
RPC0007262	Niveli profesional	Zyrtar për Shpenzime	Profesional 2	E suksesshme
RPC0007261	Niveli profesional	Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa	Profesional 1	E suksesshme
RPC0007260	Niveli i ulët drejtues	Udhëheqës i Sektorit të Sportit	Drejtues i Ulët	E suksesshme
RPC0007185	Niveli i ulët drejtues	Udhëheqës i Sektorit për Politika dhe Menaxhim	Drejtues i Ulët	E suksesshme
RPC0007180	Niveli profesional	Zyrtar për Gjendje Civile 1	Profesional 3	E suksesshme
RPC0006969	Niveli profesional	Zyrtar për Shërbime Sociale 2	Profesional 2	E suksesshme
RPC0006904	Niveli profesional	Inspektor i Shërbimeve Publike	Profesional 1	E suksesshme
RPC0006847	Niveli i ulët drejtues	Udhëheqës i Sektorit për Bashkësi Lokale	Drejtues i Ulët	E suksesshme
RPC0006841	Niveli profesional	Zyrtar për komunikim me publikun	Profesional 2	E suksesshme
RPC0006840	Niveli profesional	Zyrtar për Shërbime Sociale 2	Profesional 2	E suksesshme
RPC0006833	Niveli i ulët drejtues	Drejtor i Qendrës për Punë Sociale	Drejtues i Ulët	E suksesshme
RPC0006866	Niveli profesional	Asistent Administrativ	Profesional 3	E suksesshme
RPC0006621	Niveli profesional	Zyrtar i të Hyrave Financiare	Profesional 2	E suksesshme
RPC0006619	Niveli profesional	Zyrtar për Kadastër dhe Gjeodezi 2	Profesional 2	E suksesshme
RPC0006617	Niveli profesional	Zyrtar i lartë për kadastër	Profesional 1	E suksesshme
RPC0006614	Niveli profesional	Zyrtar i Lartë i Prokurimit	Profesional 1	E suksesshme
RPC0006610	Niveli i ulët drejtues	Udhëheqës i prokurimit 1	Drejtues i Ulët	E suksesshme
RPC0006609	Niveli profesional	Zyrtar i Lartë i Prokurimit	Profesional 1	E suksesshme
RPC0006431	Niveli profesional	Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim	Profesional 1	E suksesshme
RPC0006421	Niveli profesional	Zyrtar i Lartë për Planifikim dhe Zhvillim	Profesional 1	E suksesshme

RPC0006408	Niveli profesional	Zyrtar për Shërbim me Qytetarë	Profesional 3	E suksesshme
RPC0006407	Niveli profesional	Zyrtar për Mbështetje Administrativo Teknike të Kuvendit Komunal	Profesional 3	E suksesshme
RPC0006406	Niveli profesional	Zyrtar për Gjendje Civile 1	Profesional 3	E suksesshme

Pranimi në Shërbim Publik

Në konkurset e shpallura për vitet 2024 për Institucionet Edukative Arsimore dhe Aftësuese, për Kujdesin Shëndetësor Primar, SHPMPF (Shtëpia e Personave të Moshuar dhe Pa Përkujdesje Familjare) dhe Institucionet Kulturore (Niveli i Ulët Drejtues) janë rekrutuar gjithësej 352 Shërbyes Publik, nga të cilët 91 personel për institucione shëndetësore të kujdesit primar shëndetësor dhe SHPMPF, 3 Nivel i Ulët Drejtues për Teatrin e Qytetit, Bibloteken Hivzi Sulejmani dhe Qendrën Kulturore të Fëmijëve. Gjithashtu janë rekrutuar edhe 258 Shërbyes Publik për Institucionet Edukativo Arsimore duke përfshirë: Mësimdhënës, Asistentë të Fëmijëve me Nevoja të vecanta, Interpret të Gjuhës së Shenjave, Sekretar, Administrator etj.

Konkursi për Shërbyes Publik për Vitin 2024




Grafikoni 2

Pranimi për Staf Administrativ/ Teknik

Krahas kategorive tjera të nëpunësve publik, Sektori i Burimeve Njerëzore ka organizuar edhe procedurat e rekrutimit të Stafit Administrativ/Teknik, duke administruar procedurat e aplikimit, si dhe intervistuar aplikantët për përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Gjithësej gjatë vitit 2024, janë shpallur 5 procedura të rekrutimit për Staf Administrativ Teknik, nga të cilat janë përfunduar gjithësej 4 procedura, ndërsa 1 procedurë ka dështuar për Teknik të Pylltarisë për Shkak të Ndryshimit të Ligjit për Pyjet.

Në vazhdim janë të paraqitur përmes Grafikonit 3 Numri i Procedurave të shpallura.

Pranimi për Staf Administrativ/ Teknik



Grafikoni 3

Kodi Code Kod	Titulli i pozitës së punës Job position title Naziv radnog mesta	Statusi Status Status	Statusi i shpalljes Advertisement status Status oglasa
RPC0008989	Konkurs - Vozitës - Komuna e Prishtines - Drejtoria e Shëndetsise - QKMF	Në proces	Publikuar
RPC0008979	Konkurs per pranim per pozitën Vozitës - Drejtoria e Administrates - Komuna e Prishtinës	Në proces	Publikuar
RPC0006687	Rrobalarëse - Drejtoria e Shëndetsisë - Komuna e Prishtinës	Në proces	Në verifikim paraprak
RPC0006686	Higjienist - Drejtoria e Shëndetsisë - Komuna e Prishtinës	Në proces	Në verifikim paraprak
RPC0006632	Drejtoria e Inspeksionit - Teknik i Pylltarisë për Mbrojtje dhe Monitorim	E dështuar	E dështuara

Sa i përket konkurseve në materialin paraprak në formë të detajuar janë të listuara pozitat, drejtoritë dhe numri i kandidatëve dhe aplikantëve për secilin konkurs. Në vazhdim do listohen disa nga angazhimet të cilat kryen vazhdimisht Sektori i Burimeve Njerëzore të Kryeqytetit.

Plani Vjetor i Trajnimeve – Sektori i Burimeve Njerëzore, pasi pranon kërkesat dhe sygjerimet nga Drejtoritë dhe Sektorët për tema të caktuara, përkujdeset që të organizoj trajnimet e kërkuara dhe eventualisht të sygjeroj trajnime të cilat ndikojnë direkt në zhvillimin profesional dhe përgatitjen e nëpunësve. Për të përcjellur trendet e reja si dhe për të arritur në një nivel më të mirë të performancës profesionale, listohen trajnimet, përgatitet ngjarja paraprakisht si dhe në varësi të nevojave sigurohet edhe pjesëmarrja e ligjëruesve

kompetent që krahas trajnimit edhe të dokumentojnë pjesëmarrjen e nëpunësve përmes dëshmimeve të pjesëmarrjes/certifikatave, si dhe të njejtat i vendosen në dosjet personale të çdo nëpunësi.

Vërtetimet për njohje të përvojës së punës (angazhimit profesional) – Për nëpunësit aktual si dhe për nëpunësit të cilët kanë qenë të angazhuar më herët, sektori i burimeve njerëzore asiston ata me dokumente (vërtetime) të cilat dëshmojnë periudhën e angazhimit profesional për ata që kanë ndërprerë mardhënien e punës (kanë dalë në pension) apo për personat tjerë që është e nevojshme për zhvillim të mëtutjeshëm profesional.

Aktet juridike (vendime dhe të ngjajshme) – me qëllim lehtësimin e ofrimit të shërbimeve për nëpunësit publik dhe organizimit të punës në shërbimin civil dhe publik të kryeqytetit, sektori përgatitë forma të ndryshme të vendimeve për pezullim vullnetar, urdhëresat për angazhim shtesë, vendim për pezullim për zhvillim profesional, vendim për ndërprerje të mardhënies së punës, vendim për pushim të lehonisë, vendim për pension të parakohshëm si dhe vendime për themelimin të komisioneve.

Komisioni Disiplinor për Shërbyes Civil – i themeluar në bazë të vendimit të nënshkruar nga Zytari Kryesor Administrativ (Kryetari i Kryeqytetit), shqyrëton raportimet për shkelje disiplinore të nëpunësve civil, për të cilët vlerësohet se kanë shkelur dispozitat ligjore, kan kryer ndonjë shkelje disiplinore apo çështje të ngjajshme që ndikojnë në performancën e punës së nëpunësit civil, duke marrë vendim konform fakteve dhe dëgjimit të personave fizik subjekt i trajtimit nga ana e komisionit.

Komisioni Disiplinor për Shërbyes Publik - i themeluar në bazë të vendimit të nënshkruar nga Zytari Kryesor Administrativ (Kryetari i Kryeqytetit), shqyrëton raportimet për shkelje disiplinore nga ana e shërbyesve publik, duke vlerësuar saktësinë e raportimeve duke marrë vendim konform fakteve dhe dëgjimit të personave fizik subjekt i trajtimit nga ana e komisionit.

Komisioni i Ankesave – i cili ka qenë i themeluar në bazë të vendimit të nënshkruar nga Zytari Kryesor Administrativ (Kryetari i Kryeqytetit) për të shqyrëtuat ankesat nga të gjithë zyrtarët publik, ku me rastin e ndryshimit të ligjit trajton ankesat e Shërbyesve Publik dhe Stafit Administrativ/Teknik. Trajton paknaqësit dhe ankesat e kandidatëve që aplikojnë për pozita në këto kategori apo për personat në mardhënie pune të cilët si shkallë të parë të ankesës e kanë këtë komision. Gjithashtu kërkesat dhe ankesat individuale trajtohen duke ofruar përgjigje, udhëzuar apo ofruar zgjidhje varësisht nga situata dhe natyra e kërkesës apo ankesës së parashtruar.

Angazhime tjera profesionale dhe administrative që mbështesin punën e drejtorive dhe lehtësimin e punës dhe të performancës së nëpunësve publik.

Ky raport përgatitet nga Sektori i Burimeve Njerëzore, në funksion të përmbushjes së obligimeve ligjore të cilat burojnë nga Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, gjegjësisht Neni 16 Paragrafi 4.

Ky raport përgatitet nga Sektori i Burimeve Njerëzore, në funksion të përmbushjes së obligimeve ligjore të cilat burojnë nga Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, gjegjësisht Neni 16 Paragrafi 4.

Punuar nga:



EADIL ALIU

Menaxher i Burimeve Njerëzore

Miratur nga:



PËRPARIM RAMA

Kryetar i KRYEQYTETIT

10